



Eskpertët fiskal në Mazars kanë përgatitur buletin informativ, i cili përmbledh masat fiskale të rradhës në mbështetje të bizneseve për të parballuar emergjencën COVID 19 si dhe disa detajime të ndryshimeve ligjore të prezantuara me paketën fiskale 2020.

Masa të karakterit fiskal në kuadër të COVID 19

Masa të tjera lehtësuese parashikohen për tatimpaguesit në kuadër të përballimit të situatës emergjente të shkaktuar nga COVID 19:

- Për tatimpaguesit me qarkullim deri në 14 000 000 (katërbëdhjetë milion) lekë, këstet e parapagimeve të tatim-fitimit të vitit 2020 **nuk do të paguhen**. Përpara këtij ndryshim, këstet duhet të paguheshin në cfarëdo periudhe, mjaftonte brënda vitit 2020.
- Për tatimpaguesit me qarkullim mbi 14 000 000 (katërbëdhjetë milion) lekë, këstet e tatimit mbi fitimin për periudhat tatimore të tremujorit të dytë dhe të tretë (përkatësisht prill-qershor dhe korrik-shtator 2020) **do të shtyhen** në periudhën prill-shtator 2021*. Përpara këtij ndryshimi këstet do të paguheshin rregullisht sipas përcaktimeve ligjore (30 mars, 30 qershor, 30 shtator dhe 30 dhjetor).

** Ky përjashtim nuk zbatohet për tatimpaguesit që zhvillojnë veprimtari ekonomike në fushën e veprimtarisë bankare, të telekomunikacionit, të tregimit të produkteve farmaceutike, të produkteve ushqimore dhe frutaperimeve.*

- Për tatimpaguesit që zhvillojnë veprimtari ekonomike në fushën e turizmit, të përpunimit aktiv me material porositiesi dhe call center, këstet e tatimit mbi fitimin për periudhat tatimore prill-dhjetor 2020 **do të shtyhen** në periudhën prill-dhjetor 2021. Përpara këtij ndryshimi, subjektet kishin shtyrje afatesh në varësi të të ardhurave vjetore përkatëse.
- Për individët që kanë detyrimin për dorëzim të deklaratës vjetore individuale të të ardhurave, vetëm për vitin 2019, dorëzimi i deklaratës dhe pagesa e detyrimit nëse rezulton, kryhet brenda datës 31 korrik 2020. Përpara këtij ndryshimi, afati i dorëzimi ishte 30 prill 2020.

Burimi: Fletorja Zyrtare Nr. 73 "Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 18, datë 23.4.2020".

Buletin informativ

Ndryshime të prezantuara me paketën fiskale 2020

Përrjashtimi nga tatimi mbi të ardhurat personale i të ardhurave të përfituara nga kalimi i të drejtës së pronësisë

Duke filluar nga janari 2020, përjashtohet nga tatimi mbi të ardhurat personale kalimi i pronësisë brenda familjes nëpërmjet dhurimit apo heqjes dorë.

Në mënyrë që e ardhura të përjashtohet nga tatimi, në momentin e dhurimit dhe/ose heqjes dorë nga pasuria, nevojiten të depozitohen pranë noterit:

1. Akti i dhurimit ose i heqjes dorë;
2. Dokumenti/vërtetimi që provon lidhjen gjinore.

Për efekt të llogaritjes së të ardhurës së përjashtuar, skema e mëposhtme aplikohet:

Çmimi i banesës/truallit të regjistruar në regjistrin kadastral	<	Çmimi minimal fiskal i banesës/truallit i përcaktuar në udhëzimin e Këshillit të Ministrave	Merret në konsideratë çmimi minimal fiskal.
	>		Merret në konsideratë parasysh çmimi i regjistruar në regjistrin kadastral.

Deklarata individuale vjetore e të ardhurave për individët e punësuar në më shumë se një subjekt

Detyrimi për të plotësuar deklaratën e të ardhurave individuale për individët e dypunësuar, pavarësisht shumës së të ardhurave të përfituara, zbatohet për individët duke filluar nga 1 janari 2020. Individët rezidentë ose jorezidentë deklarojnë në deklaratën e tyre vjetore të të ardhurave, në një shumë të vetme, të gjitha të ardhurat e siguruar nga punësimi, llogarisin shumën totale të detyrimit tatimor mbi pagat sikur kjo të ishte një e vetme, dhe zbresin (kur është rasti) tatimin e mbajtur nga punëdhënësi.

Sponsorizimet për veprimtaritë e ekipeve sportive, pjesë të federatave sportive të njohura nga legjislacioni në fuqi

Duke filluar nga 1 janar 2020, sponsorizimet e veprimtarive të ekipeve sportive, të kryera nga tatimpaguesit të cilët realizojnë një fitim vjetor të tatueshem mbi 100 milion lek, janë shpenzime të njohura për efekte fiskale deri në masën e tre-fishit të vlerës së sponsorizuar. Për të përfutur nga lehtësia në fjalë, tatimpaguesi duhet të disponojë "Autorizimin e Sponsorizimit" të lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Për t'u pajisur me këtë autorizim është e nevojshme paraqitja e disa dokumenteve si nga ana e sponsorizuesit ashtu dhe nga ajo e përfutuesit; dokumenta të cilat specifikohen në Udhëzim.

Mbartja e humbjeve për 5 vjet për tatimpaguesit të cilët investojnë mbi 1 miliard lekë në aktive afatgjata materiale

Në mënyrë që të përfitohet nga zgjatja e afatit të mbartjes së humbjeve, tatimpaguesit në momentin e dorëzimit të pasqyrave financiare duhet të paraqesin pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore dokumentacionin përkatës që provon se vlera e investimit është mbi 1 miliard lekë dhe mbartja e humbjes është ushtruar në mënyrën e duhur. Dokumentacioni përfshin pasqyrat financiare të audituara, kontrata e investimeve, plani i investimeve, projektet e miratuara etj.

Burimi: Fletorja Zyrtare Nr. 64, "Udhëzimi nr.15, datë 03.04.2020, lidhur me disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 5, datë 30.1.2006 "Për tatimin mbi të ardhurat".

Buletin informativ

KONTAKT

MAZARS ALBANIA & KOSOVO

Për më shumë detaje për çështjet e mësipërme apo të tjera në lëmin fiskal, ju lutem drejtohuni:

Teit GJINI

Managing Partner
teit.gjini@mazars.al

Erinda XHAFERRAJ

Head of Tax Advisory Services
erinda.xhaferraj@mazars.al

Adresa

Rr. Emin Duraku, Pall. Binjaket, Nr.5,
Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 2222 889
E-mail: info@mazars.al